

Emertimi dhe Forma ligjore SIGNS & ROAD SAFETY SOLUTIONS SHPK

NIPT -i L62228020U

Adresa e Selise Rruga Panorama, Tiranë

Vendi i Bisnesit. Tiranë

Data e themelimit 27.10.2016

Data e Regjistrimit 28.10.2016

Nr. i Regjistrimit Tregëtar _____

Veprimtaria Kryesore Sinjalistikë, siguri rrugore, konstruksione metalike, studim, projektim, konsulencë në fushën e ndërtimeve etj. Cdo veprim tjetër që ka lidhje apo është në funksion të realizimit të objektit.

PASQYRAT FINANCIARE

(Në zbatim të Standartit Kombëtar të Kontabilitetit Nr.2 të përmirësuar dhe Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar)

Viti 2024

| | |
|---|-----------------|
| Pasqyrat Financiare janë individuale | Po |
| Pasqyrat Financiare janë të konsoliduara | Jo |
| Pasqyra Financiare janë të shprehura në | Leke |
| Pasqyrat Financiare janë të rumbullakosura në | |
| Periudha Kontabël e Pasqyrave Financiare | Nga 01.01.2024 |
| | Deri 31.12.2024 |
| Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare | 18.03.2025 |



Pasqyrat financiare te vitit 2024
Signs & Road Safety Solutions sh.p.k
L62228020U
Lek
Pasqyra e Pozicionit Financiar

| | Sheni me | Periudha Raportuese 2024 | Periudha Para ardhese 2023 |
|--|-------------|--------------------------------|----------------------------------|
| AKTIVET | | | |
| Aktive afatshkurtra | | | |
| Mjete monetare | 1 | 873,655 | 194,305 |
| Investime | | | |
| <i>Ne tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i> | | | |
| <i>Ne tituj pronesie te njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese aksione te veta</i> | | | |
| <i>Te tjera financiare</i> | | | |
| Te drejta te arketueshme | | | |
| <i>Nga aktiviteti i shfrytezimit</i> | 2 | 97,911,116 | 46,879,092 |
| <i>Nga njesite ekonomike brenda grupit *</i> | | | |
| <i>Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i> | | | |
| <i>Te tjera</i> | 3 | 102,001,493 | 56,109,480 |
| <i>Kapital i nenshkruar i papaguar</i> | | | |
| Inventaret | | | |
| <i>Lende e pare dhe materiale te konsumueshme</i> | 4 | 8,680,189 | 6,801,276 |
| <i>Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte</i> | | | |
| <i>Produkte te gatshme</i> | | | |
| <i>Mallra</i> | | | |
| <i>Aktive biologjike (gje e gjalle ne rritje dhe majmeri)</i> | | | |
| <i>AAGJM te mbajtura per shitje</i> | | | |
| <i>Parapagime per inventar</i> | 5 | 2,398,305 | 225,081 |
| Shpenzime te shtyra | 6 | 5,548,079 | 8,363,310 |
| Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara | | | |
| Totali i aktiveve afatshkurtra | | 217,412,837 | 118,572,544 |
| Aktive afatgjate | | | |
| Aktive financiare | | | |
| <i>Tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i> | | | |
| <i>Tituj pronesie te njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i> | | | |
| <i>Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike brenda grupit *</i> | | | |
| <i>Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i> | | | |
| <i>Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjate</i> | | | |
| <i>Tituj te tjere te huadhenies</i> | | | |
| Aktive materiale | | | |
| <i>Toka dhe ndertesa</i> | 7.1 | | |
| <i>Impiante dhe makineri</i> | 7.1 | 40,824,676 | 13,896,240 |
| <i>Te tjera instalime dhe pajisje</i> | 7.1 | 1,940,095 | 1,066,689 |
| <i>AAGJM te mbajtura per investim</i> | | | |
| <i>Parapagime per aktive materiale dhe ne proces</i> | 7.2 | | |
| Aktivet biologjike | | | |
| Aktive jo materiale | | | |
| <i>Koncensione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme</i> | 7.3 | | |
| <i>Emri i mire</i> | 7.3 | | |
| <i>Parapagime per AAJM</i> | 7.4 | | |
| Aktivet tatimore te shtyra | | | |
| Totali i aktiveve afatgjate | | 42,764,771 | 14,962,929 |
| TOTALI I AKTIVEVE | | 260,177,608 | 133,535,473 |

Administrator
Hendi Shehaj



Pasqyrat financiare te vitit 2024
Signs & Road Safety Solutions sh.p.k
L62228020U

Lek

Pasqyra e Pozicionit Financiar
DETYRIMET DHE KAPITALI

Detyrime afatshkurtra

| | Periudha Raportuese 2024 | Periudha Para ardhese 2023 |
|--|--------------------------|----------------------------|
| Titujt e huamarrjes | 8.1 | |
| Detyrime ndaj institucioneve te kredise | 8.2 | 28,359,653 |
| Aktetime ne avance per porosi | 9 | 2,594,632 |
| Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit | 10 | 30,407,753 |
| Deftesa te pagueshme | | 9,811,269 |
| Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit * | | |
| Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese | | |
| Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsores | 11 | 4,528,540 |
| Te pagueshme per detyrime tatimore | 12 | 25,442,466 |
| Te tjera te pagueshme | 13 | 7,852,000 |
| Te pagueshme per shpenzime te konstatuara | | |
| Te ardhura te shtyra | | |
| Provizione | | |
| Totali i detyrimeve afatshkurtra | 99,185,044 | 69,264,788 |

Detyrime afatgjata

| | | |
|--|-------------------|------------|
| Titujt e huamarrjes | 8.3 | |
| Detyrime ndaj institucioneve te kredise | 8.4 | 12,663,300 |
| Aktetime ne avance per porosi | | |
| Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit | | |
| Deftesa te pagueshme | | |
| Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit * | | |
| Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese | | |
| Te tjera te pagueshme | | |
| Te pagueshme per shpenzime te konstatuara | | |
| Te ardhura te shtyra | | |
| Provizione | | |
| Provizione per pensione | | |
| Provizione te tjera | | |
| Detyrime tatimore te shtyra | | |
| Totali i detyrimeve afatgjata | 12,663,300 | 0 |

Detyrime totale

111,848,344 **69,264,788**

Kapitali dhe Rezervat

| | | |
|--|--------------------|-------------------|
| Kapitali i nenshkruar | 100 | 100 |
| Primi i lidhur me kapitalin | | |
| Rezerva rivleresimi | | |
| Rezerva te tjera | | |
| Rezerva ligjore | | |
| Rezerva statutore | | |
| Rezerva te tjera | 64,270,586 | 34,810,588 |
| Diferenca nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja | | |
| Fitimi/(humbja) e pashperndare | | |
| Fitimi/(humbja) e periudhes | 84,058,578 | 29,459,997 |
| Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike | 148,329,264 | 64,270,685 |
| Interesa jo-kontrollues | | |
| Totali i kapitalit | 148,329,264 | 64,270,685 |

TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT

260,177,608 **133,535,473**

Administrator
Hendi Shehaj



Pasqyrat financiare te vitit 2024
Signs & Road Safety Solutions sh.p.k
L62228020U

Lek

Pasqyra e Performances (sipas natyres)

| Shenime | Periudha Raportuese 2024 | Periudha Para ardhese 2023 |
|---|--------------------------|----------------------------|
| Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit | 14 | |
| <i>Te ardhurat nga aktiviteti kryesor</i> | 14.1 | 219,245,760 |
| <i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 1</i> | 14.1 | 5,341,420 |
| <i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 2</i> | 14.1 | |
| <i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 3</i> | 14.1 | |
| <i>Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit</i> | 14.1 | 4,059,871 |
| Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces | | |
| Te ardhura nga puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar | 14.2 | |
| Te ardhura te tjera te shfrytezimit | 14.3 | |
| Lenda e pare dhe materiale te konsumeshme | 15 | |
| <i>Lenda e pare dhe materiale te konsumeshme</i> | 15.1 | -32,802,328 |
| <i>Te tjera shpenzime</i> | 15.2 | -17,831,615 |
| Shpenzime te personelit | 16 | |
| <i>Paga dhe shperblime</i> | 16.1 | -30,925,488 |
| <i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore</i> | 16.2 | -5,145,547 |
| <i>Shpenzimet per pensionet</i> | | |
| Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale | | |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 17 | -5,776,317 |
| Shpenzime te tjera shfrytezimi | 18 | -30,049,812 |
| Te ardhura te tjera | | |
| <i>Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit*</i> | | |
| <i>Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese aktiveve afatgjata *</i> | | |
| <i>pjesmarrese, pjese e aktiveve afatgjata grupit *</i> | | |
| <i>interesa pjesmarrese</i> | | |
| Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra | | |
| Shpenzime financiare | | |
| <i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme</i> | 19 | -2,871,397 |
| <i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme per tu paguar tek njesite ekonomike brenda grupit *</i> | | |
| <i>Shpenzime te tjera financiare</i> | 20 | 55,556 |
| Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet | | |
| Te tjera (pershkruaj) | | |
| Fitimi/(humbja) para tatimit | | 99,240,232 |
| Tatimi mbi fitimin | | |
| <i>Tatimi mbi fitimin e periudhes</i> | 21 | -15,181,654 |
| <i>Tatim fitimi i shtyre</i> | | |
| <i>Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve</i> | | |
| Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A) | | 84,058,578 |
| | | 29,459,997 |

Te ardhura te tjera gjithepershireshe per periudhen/vitin:

Diferenca (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja

Diferenca (+/-) nga rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale

Diferenca (+/-) nga rivleresimi i aktiveve financiare te mbajtura per shitje

Pjesa e te ardhurave gjithepershireshe nga pjesmarrjet

Te tjera (pershkruaj)

Totali i te ardhurave te tjera gjithepershireshe per periudhen/vitin (B)

Totali i te ardhurave gjithepershireshe per periudhen/vitin (A+B)

Totali i te ardhurave gjithepershireshe per :

Pronaret e njesise ekonomike meme

Interesat jo-kontrollues

* ne rastin e pasqyrave financiare te konsoliduara llogarite me njesite ekonomike brenda grupit eliminohen dhe nuk paraqiten ne pasqyren e performances

| | | |
|--|---|---|
| | | |
| | 0 | 0 |

| | | |
|--|------------|------------|
| | 84,058,578 | 29,459,997 |
|--|------------|------------|



Pasqyrat financiare te vitit 2024
Signs & Road Safety Solutions sh.p.k
L62228020U

Lek

Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare (metoda indirekte)

| | Periudha Raportuese 2024 | Periudha Raportuese 2023 |
|--|--------------------------------|--------------------------------|
| Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit: | | |
| Fitimi/(Humbja) e periudhes | 84,058,578 | 29,459,997 |
| <i>Rregullime per shpenzimet jo-monetare:</i> | | |
| Shpenzimet financiare jomonetare | -55,556 | -647,177 |
| Shpenzime per tatimin mbi fitimin jo-monetar (diferenca shpenzim - pagese gjate | 15,181,654 | 6,708,469 |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 5,776,317 | 2,948,956 |
| Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale | | |
| Zhvleresimi i te drejtave te arketueshme | | |
| Ulje ne vleren neto te realizueshme per inventaret | | |
| Provizione per shpenzime | | |
| Shpenzime te konstatuara (Shpenzime te shtyra) | 2,815,232 | -1,234,966 |
| Te ardhura te konstatuara (Te ardhura te shtyra) | | |
| Te tjera (pershkruaj) Te ardhura te tjera jo-monetare | | |
| Te tjera (pershkruaj)Shpenzime Interesi | | |
| Fluksi i mjeteve monetare i perfshire ne aktivite investuese | | |
| (Fitim)/humbja nga shitja e aktiveve afatgjata materiale | | |
| (Fitim)/humbja nga investimet ne pjesmarrje | | |
| Interesa te fituara | | |
| Te tjera (pershkruaj) | | |
| Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit | | |
| Renie/(Rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera | -96,924,037 | -56,579,448 |
| Renie/(Rritje) ne inventar | -4,052,137 | -636,874 |
| Rritje/(Renie) ne detyrime te pagueshme | 13,543,088 | 10,956,451 |
| Rritje/(Renie) ne detyrime per punonjesit | -2,025,068 | 4,655,770 |
| Te tjera (pershkruaj) | | |
| Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit | 18,318,071 | -4,368,822 |
| Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit | | |
| Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale | -33,578,159 | -6,017,257 |
| Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale | | |
| Para te perdorura per blerjen e filjaleve (netuar me shumen e mjeteve monetare pjese e | | |
| Para te arketuara nga shitja e filjaleve (netuar me shumen e mjeteve monetare pjese e | | |
| aktiveve neto te shitura) | | |
| Pagesa per blerjen e investimeve te tjera | | |
| Arketime nga shitja e investimeve te tjera | | |
| Dividente te arketuar | | |
| Interesa te arketuara | | |
| Te tjera (pershkruaj) | | |
| Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit | -33,578,159 | -6,017,257 |
| Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit | | |
| Arketime nga emetimi i kapitalit te nenshkruar | | |
| Arketime nga emetimi i aksioneve te perdorura si kolateral | | |
| Hua te arketuara | 15,883,882 | 9,270,114 |
| Pagesa e kostove te transakcionit qe lidhet me kredite dhe huate | | |
| Riblerje e aksioneve te veta | | |
| Pagesa e aksioneve te perdorura si kolateral | | |
| Pagesa e huave | | |
| Pagese e detyrimeve te qirase financiare | | |
| Interes i paguar | | |
| Dividende te paguar pronareve te njesive ekonomike meme | | |
| Dividende te paguar interesave jokontrollues | | |
| Te tjera (pershkruaj) | | |
| Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit | 15,883,882 | 9,270,114 |
| Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to | 623,794 | -1,115,965 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim | 194,305 | 663,093 |
| Efekti i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare | 55,556 | 647,177 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund | 873,655 | 194,305 |
| Administrator | | |
| Hendi Shehaj | | |



Pasqyrat financiare te vitit 2024

Signs & Road Safety Solutions sh.p.k

L62228020U

Lek

Pasqyra e levizjeve ne kapitalin neto

| Kapitali i nenshkruar | Primi lidhur me kapitalin | Rezerva mi rivleresi | Rezerva tjera | Diferenca nga perktimi i monedhes ne veprimtari te huaja | Fitimet/ (humbjet) e pasqperndara | Fitim/(humbja) e periudhes | Totali | Interesa jo-kontrollues | Totali |
|-----------------------|---------------------------|----------------------|---------------|--|-----------------------------------|----------------------------|-------------|-------------------------|-------------|
| | | | | | | | | | |
| 100 | 0 | 0 | 32,692,921 | 0 | 0 | 2,117,667 | 34,810,688 | 0 | 34,810,688 |
| 100 | 0 | 0 | 32,692,921 | 0 | 0 | 2,117,667 | 34,810,688 | 0 | 34,810,688 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 29,459,997 | 29,459,997 | 0 | 29,459,997 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 29,459,997 | 29,459,997 | 0 | 29,459,997 |
| 0 | 0 | 0 | 2,117,667 | 0 | 0 | -2,117,667 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 0 | 0 | 2,117,667 | 0 | 0 | -2,117,667 | 0 | 0 | 0 |
| 100 | 0 | 0 | 34,810,588 | 0 | 0 | 29,459,997 | 64,270,685 | 0 | 64,270,685 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 84,058,578 | 84,058,578 | 0 | 84,058,578 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 84,058,578 | 84,058,578 | 0 | 84,058,578 |
| 0 | 0 | 0 | 29,459,998 | 0 | 0 | -29,459,997 | 1 | 1 | 1 |
| 0 | 0 | 0 | 29,459,998 | 0 | 0 | -29,459,997 | 1 | 0 | 1 |
| 100 | 0 | 0 | 64,270,586 | 0 | 0 | 84,058,578 | 148,329,264 | 0 | 148,329,264 |

Pozicioni financiar ne fillim 2022

Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabile

Pozicioni financiar i ridekluar ne fillim 2023

Te ardhurat totale gjithepershires te periudhes:

Fitim/(humbja) e periudhes

Te ardhura te tjera gjithepershires

Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura drejtpdreit ne kapital

Totali i te ardhurave gjithepershires per periudhen

Transaksione per pronaret e njesis ekonomike te njohura direkt ne kapital:

Emetim i kapitalit te nenshkruar

Dividende te shperndare

Percaktime te tjera per rezultatit e periudhes (pershkruaj)

Totali i transaksioneve per pronaret e njesis ekonomike

Pozicioni financiar ne fund (viti paraardhes) 2023

Te ardhurat totale gjithepershires te periudhes:

Fitim/(humbja) e periudhes

Te ardhura te tjera gjithepershires

Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura drejtpdreit ne kapital

Totali i te ardhurave gjithepershires per periudhen

Transaksione per pronaret e njesis ekonomike te njohura direkt ne kapital:

Emetim i kapitalit te nenshkruar

Dividende te shperndare

Percaktime te tjera per rezultatit e periudhes (pershkruaj)

Totali i transaksioneve per pronaret e njesis ekonomike

Pozicioni financiar ne fund (viti aktual) 2024



Administratori

Hendi Shefaj

Sh.p.k.

L62228020U

Signs&Road Safety Solutions
L62228020U

Gjendja dhe ndryshimi i AAM-ve me kosto historike

Pasqyra Nr.4

| | Gjendja më 31/12/2023 | Shtesat Blerë dhe Krijuar | Pakësime nga shitja | Pakësime të tjera nga çrregjistri mi | Pakësime të tjera (riciklim) | Riklasifiki me | Gjendja më 31/12/204 | Totali sipas zërave paraqitur në PPF |
|-----------------------|--------------------------|---------------------------------|------------------------|--|------------------------------------|-------------------|-------------------------|---|
| Pershtatje ambjentesh | | | | | | | - | - |
| Makineri pajisje | 13,224,717 | 31,853,542 | | | | | 45,078,259 | 56,163,955 |
| Mjete Transporti | 10,544,029 | 541,667 | | | | | 11,085,696 | |
| Mobilje e orendi | 1,039,093 | 157,708 | | | | | 1,196,801 | 3,244,827 |
| Pajisje Informatike | 465,397 | 176,543 | | | | | 641,940 | |
| Te tjera AAM | 557,386 | 848,700 | | | | | 1,406,086 | |
| TOTALI | 25,830,622 | 33,578,160 | - | - | - | - | 59,408,782.00 | 59,408,782 |

Gjendja dhe ndryshimi i Amortizimit te AAM-ve

| | Gjendja më 31/12/2023 | Shtesat Amortizimi Vjetor | Pakësime nga shitja | Pakësime të tjera nga çrregjistri mi | Pakësime të tjera (riciklim) | Riklasifiki me | Gjendja më 31/12/2024 | Totali sipas zërave paraqitur në PPF |
|---------------------|--------------------------|---------------------------------|------------------------|--|------------------------------------|-------------------|--------------------------|---|
| Ndertesë | | | | | | | - | - |
| Makineri pajisje | 4,463,055 | 4,349,581 | | | | | 8,812,636 | 15,339,280 |
| Mjete Transporti | 5,409,451 | 1,117,193 | | | | | 6,526,644 | |
| Mobilje e orendi | 475,460 | 121,855 | | | | | 597,315 | 1,304,731 |
| Pajisje Informatike | 329,583 | 59,700 | | | | | 389,283 | |
| Te tjera AAM | 190,145 | 127,988 | | | | | 318,133 | |
| TOTALI | 10,867,694 | 5,776,317 | - | - | - | - | 16,644,011 | 16,644,011 |

Vlera Neto e AAM-ve

| | Gjendja më 31/12/203 | | Gjendja më 31/12/2024 | Totali sipas zërave paraqitur në PPF |
|---------------------|-------------------------|---|--------------------------|---|
| Ndertesë | - | | - | - |
| Makineri pajisje | 8,761,662 | | 36,265,623 | 40,824,675 |
| Mjete Transporti | 5,134,578 | | 4,559,052 | |
| Mobilje e orendi | 563,633 | | 599,486 | 1,940,096 |
| Pajisje Informatike | 135,814 | | 252,657 | |
| Pajisje Informatike | 367,241 | | 1,087,953 | |
| TOTALI | 14,962,928 | - | 42,764,771 | 42,764,771 |

Administrator
Hendi Shehaj



INFORMACION I PËRGJITHSHËM

EMRI DHE FORMA LIGJORE: SIGNS & ROAD SAFETY SOLUTIONS SHPK, është themeluar më dt 27/10/2016 dhe është rregjistruar në QKB më dt. 28/10/2016 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK), e cila vepron në përputhje me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjeve të tjera që rregullojnë aktivitetin ekonomik, në vijim e quajtur “Shoqëria”

NUIS: L62228020U

ADRESA KRYESORE: Rruga Panorama, Tiranë

OBJEKTI I VEPRIMTARISË: Sinjalistikë, siguri rrugore, konstruksione metalike, studim, projektim, konsulencë në fushën e ndërtimeve etj. Import - Eksport i mallrave të ndryshëm.

KAPITALI THEMELTAR i shoqërisë është 100 lekë dhe zotërohet nga ortakët si më poshtë:
1-Hendi Shehaj , Shtetas Shqiptar i cili zotëron 100% të kapitalit themeltar me vlerë 100 lekë

PËRFAQËSUESI LIGJOR: Z. Hendi Shehaj

Shoqëria është e regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, Tiranë.

Gjatë vitit 2024 ajo ka ushtruar aktivitetin në përputhje me objektin e saj. Gjatë këtij viti ka patur shtesa të adresës sekondare, është shtuar adresa Sheq Marinas, Fier.

Shoqëria ne 31/12/2024 ka adresa sekondare si më poshtë:

-Tiranë Rr.Panorama

-Kamion me Tendë Mercedes Benz me targa AA225 IF

-Fier, Sheq Marinas

-Kamion Scania me targë AA349AO

-Kamion Volvo Tip E4C me targa AA254EN

Nr. i të punësuarve

| | Viti 2024 | Viti 2023 |
|--------------------------------|-----------|-----------|
| Nr. i të punësuarve 31 Dhjetor | 109 | 99 |
| Nr. mes. i punonjësve | 58 | 56 |

Ligji 25/2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", parashikon dy paketa të rregullimit kontabël:

a) Standartet Kombëtare të kontabilitetit (te njohura si SKK-të);

b) Standardet Ndërkombëtare të raportimit Financiar (të njohura si SNRF-të);

Këto standarde zbatohen për të gjitha njësitë ekonomike pavarësisht formës së tyre ligjore, me apo pa qëllim fitimi, publike apo private me përjashtim të rasteve kur pasqyrat financiare dhe kontabiliteti i tyre janë subjekt i ligjeve dhe rregullimeve të veçanta.

Sipas këtij ligji mikronjësitë, njësitë ekonomike të Vogla, të Mesme e të Mëdha duhet të zbatojnë SKK-të për ndërtimin e pasqyrave financiare përveç disa përjashtimeve.

Neni 4 i tij gjithashtu përcakton kriteret e klasifikimit në këto grupe për periudhën 2022-2024.

I - Mikronjësi ekonomike janë të gjitha ato njësi ekonomike të cilat në datën e raportimit nuk tejkalojnë kufijtë e të paktën 2 prej 3 kriterëve të mëposhtme:

a) aktivi, 25 milionë lekë;

b) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), 50 milionë lekë;

c) numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 10.

II - Njësi ekonomike të vogla - njësitë ekonomike, jo mikro, që në datën e raportimit nuk tejkalojnë kufijtë e të paktën dy prej tri kriterëve të mëposhtme:

a) aktivi, 250 milionë lekë;

b) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), 500 milionë lekë;



c) numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 50.

III - Njësi ekonomike të mesme - njësitë ekonomike, jo mikro dhe jo të vogla, që në datën e raportimit nuk tejkalojnë kufijtë e të paktën dy prej tri kritereve të mëposhtme:

a) aktivi, 1250 milionë lekë;

b) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), 2 500 milionë lekë;

c) numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 250.

IV - Njësi ekonomike të mëdha - njësitë ekonomike, që në datën e raportimit tejkalojnë kufijtë e të paktën dy prej tri kritereve të mëposhtme:

a) aktivi, 1 250 milionë lekë;

b) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), 2 500 milionë lekë;

c) numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 250.

Sipas këtyre kritereve **SIGNS & ROAD SAFETY SOLUTIONS SHPK**, klasifikohet si **Njësi ekonomike e vogël**.

Këto shënime shpjeguese janë organizuar sipas kërkesave të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit numër 2 të përmirësuar, pikat (87-88). Sipas këtyre pikave, shënimet shpjeguese do të strukturohen sipas renditjes së mëposhtme (pika 88, SKK2)

(1) **kuadrin kontabël të aplikuar;**

(2) **përshkrimin e politikave kryesore kontabël, të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare;**

(3) **informacion-shtesë mbi zërat materialë, të paraqitur në pasqyrat parësore dhe ndryshimet e tyre gjatë periudhës kontabël (pasqyrat parësore do të përmbajnë referenca që të drejtojnë në shënimet e bashkëngjitura, të cilat shpjegojnë më hollësisht informacionin e paraqitur në pasqyrat parësore);**

(4) **informacion tjetër të nevojshëm për një paraqitje të vërtetë e të besueshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë së njësisë ekonomike raportuese (për shembull, pasivët e mundshme, transaksionet me palët e lidhura, ngjarjet që kanë ndodhur pas datës së bilancit).**

Sipas strukturës së mësipërme të sugjeruar në SKK 2, pika 88 vijojnë më poshtë shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të shoqërisë **SIGNS & ROAD SAFETY SOLUTIONS SHPK**.

1. KUADRI KONTABËL PËR PËRGATITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE

(a) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare individuale të bashkëngjitura të **SIGNS & ROAD SAFETY SOLUTIONS SHPK** me **NIPT L62228020U** për vitet ushtrimore që mbyllen më **31 Dhjetor 2024**, janë përgatitur në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe **ndërtohen** në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) të përmirësuar.

Ajo i paraqet pasqyrat financiare sipas formatit të caktuar nga SKK 2, i përmirësuar.

Këto standarde kombëtare u rishikuan nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, një organizëm profesional publik i pavarur i cili merret me hartimin e standardeve kombëtare në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", në koherencë me Standartet Ndërkombëtare Kontabël si dhe me rishikimin e tyre. Rishikimi i bërë pati për qëllim të sigurojë përputhshmëri me SNRF për NVM-të. Ky rishikim u bë gjithashtu për tu siguruar se SKK-të janë në pajtueshmëri me kërkesat e Direktivave të Bashkimit Europian.

Këtu e në vijim do ti referohemi si SKK-të.

Karakteristikat cilësore dhe parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare janë:

- Parimi i paraqitjes me besnikëri;
- Parimi i përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore;
- Parimi i pa-anshmërisë pa asnjë influencim të qëllimshëm;



- Parimi i maturisë pa optimizëm të tepruar, pa nën e mbivlerësim të qëllimshëm;
- Parimin i plotësisë duke paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të performancës dhe pozicionit financiar të njësisë ekonomike;
- Parimi i qëndrueshmërisë sipas së cilës njësia ekonomike deklaron se ruan paraqitjen dhe klasifikimin e zërave në pasqyrat financiare nga njëra periudhë në tjetrën;
- Parimi i krahasueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së politikave kontabël sipas të cilit informacioni paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar të njëjtat politika kontabël si dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas SKK 2 duke ruajtur paraqitjen dhe klasifikimin e zërave në pasqyrat financiare nga njëra periudhë në tjetrën, çka e bën informacionin të krahasueshëm;
- Parimi i vijimësisë

Drejtimi i njësisë vlerëson se do të vijojë aktivitetin normal tregtar për dymbëdhjetë muajt e ardhshëm që pasojnë muajin e mbylljes së këtyre pasqyrave financiare. Si rrjedhim këto pasqyra janë përgatitur **mbi bazën e parimit të vijimësisë**.

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuara në SKK-të për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Dy bazat e parashikuara të matjes sipas SKK-ve janë kosto historike dhe vlera e drejtë. Bazat e matjes përshkruhen në detaje në politikat kontabël të mëposhtme. Sipas parimeve të kontabilitetit në Shqipëri, pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e **konceptit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara**. Mbajtja e kontabilitetit përfshin regjistrimet kontabël dhe sistemin e tij të kontabilitetit. Regjistrimet mbahen në mënyrë të kompjuterizuar me anë të një programi të kontabilitetit.

(c) Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të njësisë ekonomike dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve dhe çmuarjeve të drejtimit.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël do të japin efekt në rezultatin e periudhës në të cilën është rishikuar çmuarja si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga ky ndryshim.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të këtyre pasqyrave.

(d) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra paraqiten në monedhën shqiptare Lek e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

Vlerat në pasqyrat financiare nuk janë të rumbullakosura.

2. POLITIKAT KONTABËL KRYESORE

Në këtë seksion të shënimeve shpjeguese janë paraqitur pjesa më e madhe e politikave kontabël mbi bazën e të cilave janë përgatitur pasqyrat financiare. Këto politika janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në gjithë periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Shkurtime

PPF Pasqyra e Pozicionit Financiar



PP Pasqyra e Performancës
PFMN Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare

(a) Transaksionet në monedhë të huaj dhe tepricat në datën e raportimit

Transaksionet në monedhë të huaj përgjithësisht konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Gjatë periudhës janë përdorur kurse këmbimi ditore ose mesatare javore kur nuk ka patur luhatje të konsiderueshme (sic e lejon SKK.12 pika 12).

Në datën e raportimit, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj date.

Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin në zërin “të tjera të ardhura/shpenzime financiare” në përputhje me SKK 12 (pika 15).

Mjetet jo-monetare që njihen me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e veprimit.

Kurset e këmbimit të përdorura për përkthimin e zërave monetarë në datën 31 dhjetor janë si më poshtë:

| | 31 Dhjetor 2024 | 31 Dhjetor 2023 |
|--------|-----------------|-----------------|
| 1 EURO | 98.15 | 103.88 |
| 1 USD | 94.26 | 93.94 |

(b) Instrumentat financiarë

Instrumenti financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentat financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, llogari të arkëtueshme tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, llogari të pagueshme tregtare dhe të pagueshme të tjera, hua të dhëna dhe hua të marra. Sipas **jetëgjatësisë** së tyre ato klasifikon në **afatshkurtër** dhe **afatgjatë**.

Aktivët Financiarë

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Në këtë zë përfshihen mjetet monetare në dorë dhe ato të mbajtura në banka. Në përputhje me SKK2 “Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare”, mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare, përfshin MM në arkë, llogaritë rrjedhëse në bankë, depozita me afat si dhe ekuivalentët e MM-ve që janë investime afatshkurtra, shumë likuide të cilat mbahen më shumë për të përmbushur angazhimet afatshkurtra në mjete monetare sesa për investime ose qëllime të tjera. Prandaj, një investim normalisht kualifikohet si ekuivalent i mjeteve monetare vetëm kur ai ka një maturim të shkurtër (përgjithësisht deri në 3 muaj).

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në pasqyrën e pozicionit financiar korrespondojnë me mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre sipas përkufizimit të mësipërm

Ovërdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga MM-të dhe ekuivalentët e MM-ve.

Njohja dhe matja fillestare : në hyrje njihen me vlerën nominale që në rastin e mjeteve monetare, është vlera e drejtë e tyre.

Vlerësimi i mëpasshëm: paraqiten në PPF me vlerën nominale të tyre

Të drejta të arkëtueshme tregtare (klientët)



Njohja fillestare e kërkesave për tu arkëtuar nga klientët ndodh kur të mirat materiale të porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur ose shërbimi është kryer. Njësia ka një të drejtë ligjore për të arkëtuar mjete monetare e cila rrjedh nga fatura.

Njohja fillestare varet nga modeli i biznesit të shoqërisë për menaxhimin e tyre pra varet nga fakti nëse transaksioni përmban apo jo një element të rëndësishëm financimi.

Matja fillestare: Meqënëse klientët tregtarë janë zakonisht afatshkurtër ose nuk përmbajnë element financimi, në hyrje ato vlerësohen me koston e transaksionit e cila është shuma e paskontuar që zakonisht është çmimi i faturës.

Vlerësimi i mëpasshëm: Në PPF ato paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka).

- *Nga analiza e klientëve në këtë njësi ekonomike, nuk rezultuan zhvlerësime.*

Huadhëniet afatshkurtra

Njohja e huadhënies bëhet kur njësia bëhet pjesë e një kontrate huaje nëpërmjet së cilës jep hua me qëllim të përfitimit të një norme interesi me një afat jo më të madh se një vit.

Matja fillestare -Në hyrje njihen me koston e transaksionit e cila është vlera e mjeteve monetare të dhëna të paskontuara

Vlerësimi i mëpasshëm: Në PPF ato paraqiten me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka)

- *Shoqëria nuk ka hua afatshkurtra të dhëna për këto vite ushtrimore.*

Huadhëniet afatgjata:

Njohja e huadhënies afatgjatë bëhet kur njësia bëhet pjesë e një kontrate huaje nëpërmjet së cilës jep hua me qëllim të përfitimit të një norme interesi afati i së cilës është më i madh se një vit.

Matja fillestare -Në hyrje njihen fillimisht me koston e transaksionit (duke përfshirë dhe tarifatat shtesë) e cila është vlera aktuale e arkëtimeve të pritshme të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për instrumenta të ngjashëm

Vlerësimi i mëpasshëm -Në PPF ato paraqiten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Çdo diferencë mes vlerës në njohje (neto nga koston e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së të drejtës së arkëtueshme njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- *Shoqëria nuk ka huadhënie afatgjata të dhëna për këto vite ushtrimore.*

Kërkesa të tjera të arkëtueshme

Kërkesa të tjera për arkëtim njihen kur njësia ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Ato vlerësohen në hyrje dhe në PPF po ashtu si dhe llogaritë e arkëtueshme nga klientët.

Nga analiza e kërkesave të tjera për arkëtim, nuk rezultuan zhvlerësime për këto vite ushtrimore.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Në fund të çdo periudhe raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njësia duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

Evidenca objektive që një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare janë zhvlerësuar përfshin ngjarjet e mëposhtme të cilat vijnë në vëmendjen e mbajtësit të aktivit:

(a) vështirësi financiare domethënëse të emetuesit ose detyruesit.

- (b) një shkelle kontrate, si mospagesë ose pamundësi pagese të interesit ose principalit.
- (c) kreditori, për arsye ekonomike ose ligjore që lidhen me vështirësinë financiare të debitorit, i ofron këtij të fundit konçesione që kreditori nuk do t'i ofronte në kushte të tjera.
- (d) është bërë e mundshme që debitori do të kalojë në falimentim ose riorganizime të tjera financiare. (e) të dhënat tregojnë që ka patur një rënie të matshme në flukset e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare nga një grup aktivesh financiare që nga njohja e tyre, edhe pse rënia nuk mund të lidhet me një aktiv financiar të caktuar brenda grupit, të tilla si kushte ekonomike të dëmshme kombëtare ose vendore ose ndryshime të dëmshme në industri.
- Faktorë të tjerë mundet gjithashtu të jenë evidencë e zhvlerësimit, përfshirë ndryshime domethënëse me një efekt të dëmshëm që kanë ndodhur në mjediset teknologjike, të tregut, ekonomike apo ligjore në të cilat vepron emetuesi.

Detyrimet Financiare

Njohja fillestare e një detyrimi financiar ndodh kur njësia ekonomike bëhet palë në një kontratë dhe si rrjedhim ka detyrim ligjor për të dhënë mjete monetare ose një tjetër aktiv financiar ose kur njësia ekonomike ka marrë faturën për shërbimin ose të mirat materiale të marra (të blera).

Llogaritë e pagueshme tregtare ndaj furnitorëve

Njohja fillestare e detyrimit tregtar ndaj furnitorit bëhet kur malli është nisur, ka mbërritur ose shërbimi është kryer.

Matja fillestare - Meqënëse të gjithë furnitorët janë afatshkurtër ose nuk përmbajnë në thelb marrëveshje financimi, ato vlerësohen me koston e transaksionit e cila është shuma e paskontuar që njësia i detyrohet furnizuesit (pagesa e pritshme). Kjo shumë që njësia i detyrohet furnizuesit është vlera e faturës.

Vlerësimi i mëpasshëm - Në PPF ato paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus pagesat).

Huamarrjet afatshkurtra

Matja fillestare – Në hyrje vlerësohen me kosto e cila është vlera e mjeteve monetare të marra

Vlerësimi i mëpasshëm -Në PPF ato paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus pagesat)

Huamarrjet afatgjata

Për vlerësimin e huamarrjeve afatgjata përdoret metoda e interesit afektiv.

Matja fillestare – Në hyrje vlerësohen me kosto (duke përfshirë dhe tarifat shtesë) e cila është vlera aktuale e pagesave të pritshme të ardhshme të skontuara me një normë tregu interesi për një instrument të ngjashëm borxhi

Vlerësimi i mëpasshëm – Në PPF ato paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit afektiv. Çdo diferencë mes vlerës në njohje dhe vlerës së paguar njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas duke përdorur metodën e interesit afektiv.

-Njësia ekonomike nuk posedon huamarrje afatgjata për periudhat raportuese

Llogari të tjera të pagueshme

Llogari të tjera të pagueshme njihen kur njësia ka një të detyrim për të dhënë mjete monetare në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, dhe vlera e tyre matet në mënyrë të besueshme. Ato vlerësohen në hyrje dhe në PPF po ashtu si dhe llogaritë e pagueshme “Furnitorë”.

(c) Inventarët qarkullues

Shoqëria njih inventarin atëhere kur e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri.

Matja fillestare – Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Vlerësimi i mëpasshëm – Në PPF inventarët vlerësohen me vlerën më të ulët mes kostos historike të blerjes / prodhimit dhe vlerës së pritshme të shitjes minus kostot e përfundimit të prodhimit të produkteve dhe të realizimit të shitjes.

- *Inventarët çrregjistrohen kur dalin nga njësia ekonomike pra kur shiten ose kur nuk kanë më vlerë ekonomike.*

Zhvlerësimi i inventarëve

Njësia ekonomike vlerëson gjendjen e inventarit me qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsye të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

- *Në të gjitha rastet nuk janë konstatuar elementë të zhvlerësimit dhe kostoja historike e blerjes/prodhimit ka rezultuar më e vogla dhe pikërisht ajo është përdorur për të vlerësuar inventarin.*

(d) Aktivitet afatgjatë materiale & Jo materiale

Per vlerësimin e AAM-ve & AAJM-ve përdoret metoda e kostos historike dhe paraqiten në PPF me vlerën neto.

Matja fillestare- Në hyrje AAM-të vlerësohen me kosto në të cilin përfshihet

- kostoja e blerjes (përfshirë edhe taksat e importit dhe taksa të tjera të parimbursueshme, pasi të zbriten skontot tregtare dhe rabatet);

-kosto të tjera të drejtpërdrejta, që lidhen me sjelljen e aktivitetit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të njësive (përfshirë koston e prodhimit të aktivitetit, nëse ka të tilla kosto, kostot e përgatitjes së terrenit, livrimin fillestar dhe trajtimin, instalimin dhe montimin, si dhe testimin e tij).

Vlerësimi i mëpasshëm –Në PPF ato paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto historike minus amortizimin e akumuluar minus zhvlerësimin nëse ka) dhe raportohen me vlerën neto.

Kostot e mëpasshme

Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivitetit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundshme që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative.

Amortizimi

Amortizimi është shpërndarje sistematike e vlerës së amortizueshme së një AAM-AAJM-je përgjatë jetës së tij të dobishme. Metoda e përdorur duhet të pasqyrojë modelin se si do të realizohen përfitimet ekonomike të ardhshme nga përdorimi i tij. Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të AAM-

së duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes si dhe muajin e fundit të daljes nga njësia ekonomike dhe njihet si shpenzim periudhe duke pakësuar vlerën e aktivitetit.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Zhvlerësimi i AAM-ve & AAJM-ve

Në çdo datë raportimi shoqëria rishikon vlerën kontabël të AAM-ve & AAJM-ve për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël neto tejkalon shumën e rikuperueshme.

- Për këto aktive nuk ka tregues për zhvlerësim për periudhat raportuese.

Çrregjistrimi i AAM-ve

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çrregjistrohet kur dalin nga njësia ekonomike (shiten) apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas vlerës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

(e) Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve njihen kur ekziston një marrëveshje me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer si dhe rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së mallit apo shërbimit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitime të cilat lidhen me transaksionin mund të hyjnë në shoqëri. Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo.

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim / humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, fitim / humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjata si dhe të ardhura të tjera nga veprimtari jo operative

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria ka nxjerrë ose pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen.

Njësia ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave dhe shpenzimeve brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

(f) Qiratë

Qiratë klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qerasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare me vlerën më të vogël mes vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qerasë.

(g) Shpenzime për personelin

Sipas legjislacionit shoqëria kryen pagesa për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore në emër të saj dhe për llogari të punonjësve të saj. Kostot përkatëse të bëra në emër të shoqërisë kalojnë në rezultatit e periudhës në momentin e konstatimit të shpenzimit.

(h) Provizionet

Provizioni njihet kur shoqëria ka një detyrim aktual që ka lindur nga një ngjarje e shkuar, shlyerja e të cilit pritet të shoqërohet me dalje të burimeve dhe mund të bëhet një vlerësim relativisht i saktë i shumës së



detyrimit. Pra koha e shlyerjes ose shuma janë të pasigurta. Ngjarja detyruese mund të shkaktojë një detyrim ligjor ose konstruktiv.

- Për vitin 2024 shoqëria nuk ka njohur provizione.

(i) Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga huatë e dhëna dhe fitime nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet e marra si dhe humbje nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim / humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv.

(j) Tatimi mbi fitimin

Shoqëria llogarit tatimin mbi fitimin bazuar në legjislacionin i cili është në fuqi në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

Tatimi aktual mbi fitimin llogaritet si 15% e fitimit të tatueshëm.

Fitimi i tatueshëm llogaritet duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korrigjuar atë me shpenzimet e panjohura sipas përcaktimit në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”.

2. INFORMACION SHITESË MBI ZËRAT MATERIAL

Më poshtë paraqiten informacione shitesë mbi zërat materialë të pasqyrave financiare kryesore sipas numrave referencë që mund të gjenden në këto pasqyra.

PËR PASQYRËN E POZICIONIT FINANCIAR

1. Mjetet Monetare

873,655

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e mjeteve monetare në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë. Një paraqitje e përmblodhur e tyre jepet si më poshtë:

| | 31 Dhjetor-24 | 31 Dhjetor-23 | Ndryshimi +/- |
|-------------------------|----------------|----------------|----------------|
| Mjete Monetare në bankë | 438,369 | 97,296 | 341,073 |
| Mjete monetare në arke | 435,286 | 97,009 | 338,277 |
| Totali | 873,655 | 194,305 | 679,350 |

Gjendja e llogarive bankare në fund të periudhës 2024 përbëhet nga llogaritë rrjedhëse në Lekë dhe Euro dhe USD pranë bankave: Raiffeisen Bank, BKT, OTP Bank, Credins Bank në monedhat Lekë, Euro, Union Bank në monedhën Euro, ABI Bank në monedhat Lekë, Euro, USD. Gjendja e likuditeteve në arkë në dt 31.12.2024 përbëhet nga shuma e mjeteve monetare në monedhën Lekë që gjenden në shoqëri.

2. Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit

97,911,116

Në këtë zë paraqiten kërkesat ndaj klientëve gjendje të paarkëtuar në 31 Dhjetor 2024.



| | 31 Dhjetor-24 | 31 Dhjetor-23 | Ndryshimi +/- |
|---|-------------------|-------------------|-------------------|
| Klientë për shërbime, mallra dhe produkte | 97,911,116 | 46,879,092 | 51,032,024 |
| Totali | 97,911,116 | 46,879,092 | 51,032,024 |

Gjatë vitit 2024 ka një rritje të vlerës së klientëve . Edhe pse në rritje, këto llogari nuk paraqesin elementë për zhvlerësim.

3. Të drejta të arkëtueshme të tjera

102,001,493

Zëri të drejta të tjera të arkëtueshme përfaqëson të drejta të arkëtueshme lidhur me tatim taksat (Parapagime apo mbipagesa) si dhe të drejta të tjera të krijuara gjatë marrëdhënieve tregtare.

| | 31 Dhjetor-24 | 31 Dhjetor-23 | Ndryshimi +/- |
|---|--------------------|-------------------|-------------------|
| Të tjera tatime për t'u paguar dhe për t'u kthyer | | 35,472 | -35,472 |
| Debitorë te tjerë | 102,001,493 | 56,074,008 | 45,927,485 |
| Totali | 102,001,493 | 56,109,480 | 45,892,013 |

4. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

8,680,189

| | 31 Dhjetor-24 | 31 Dhjetor-23 | Ndryshimi +/- |
|---|------------------|------------------|------------------|
| Lëndë e parë & ndihmëse për prodhimin e produkteve apo shërbimeve | 8,680,189 | 6,801,276 | 1,878,913 |
| Lëndë e parë për prodhimin e AAM-ve | | | 0 |
| Totali | 8,680,189 | 6,801,276 | 1,878,913 |

Vlera prej 8,680,189 lekë përfaqëson lëndën e parë dhe ndihmëse të cilat përdoren për kryerjen e shërbimeve sipas objektit të vperimtarisë , sipas inventarit të datës 31 Dhjetor 2024.

Bashkëngjitur shënimeve gjendet **Pasqyra nr 3: Inventari i materialeve dt 31/12/2024**

5. Parapagime për inventar

2,398,305

| | 31 Dhjetor-24 | 31 Dhjetor-23 | Ndryshimi +/- |
|-------------------------|------------------|----------------|------------------|
| Parapagime për inventar | 2,398,305 | 225,081 | 2,173,224 |
| Totali | 2,398,305 | 225,081 | 2,173,224 |

Paraqet vlerën e parapagimeve të dhëna për inventar qarkullues.

6. Shpenzime të shtyra

5,548,079

Shpenzimet e shtyra janë në formën e shpenzimeve të realizuara efekti i të cilave shtrihet në disa periudha.



Në rezultatin e periudhës ka kaluar pjesa kuotë e llogaritur që i takon vitit 2024, sipas vlerësimeve të bëra nga drejtimi, ndërsa pjesa tjetër njihet si shpenzim i shtyrë për tu njohur si shpenzim në periudhën pasuese dhe paraqitet në këtë zë të pasqyrës.

| | 31 Dhjetor-24 | 31 Dhjetor-23 | Ndryshimi +/- |
|-------------------------------------|------------------|------------------|-------------------|
| Parapagime për shërbime (shpenzime) | | | 0 |
| Shpenzime të tjera të shtyra | 5,548,079 | 8,363,310 | -2,815,231 |
| Totali | 5,548,079 | 8,363,310 | -2,815,231 |

7. Aktivet Afatgjata Materiale & Jo Materiale

42,764,771

Aktivete Afatgjata Materiale & Jo Materiale janë paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit financiar me vlerën neto sipas grupeve që i përkasin si më poshtë:

| | 31 Dhjetor-24 | 31 Dhjetor-23 | Ndryshimi +/- |
|---------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| 7.1 AAM | 42,764,771 | 14,962,929 | 27,801,842 |
| 7.2 Paradhënie AAM | | | 0 |
| 7.3 AAJM | | | 0 |
| 7.4 Paradhënie AAJM | | | 0 |
| Totali | 42,764,771 | 14,962,929 | 27,801,842 |

7.1 Aktivet Afatgjata Materiale (Vlera Neto)

42,764,771

| | 31 Dhjetor-24 | 31 Dhjetor-23 | Ndryshimi +/- |
|--------------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Toka dhe ndertesat | | | 0 |
| Impiante dhe makineri | 40,824,676 | 13,896,240 | 26,928,436 |
| Të tjera instalime dhe pajisje | 1,940,095 | 1,066,689 | 873,406 |
| Totali | 42,764,771 | 14,962,929 | 27,801,842 |

Në zërin **impiante e makineri** janë përfshirë pajisje e vegla pune të domosdoshme për kryerjen e aktivitetit si gjenerator, vidator me goditje, makineri vijëzimi, Betoniere, printer per tabela etj si dhe mjetet e transportit përfshihen gjithashtu në këtë zë.

Në zërin **të tjera instalime dhe pajisje** përfshihen mobilje zyre, pajisje informatike e të tjera AAM të nevojshme për mbarëvajtjen e punës.

Gjendja, shtesat, pakësimet si dhe amortizimi i tyre gjatë vitit 2024 paraqitet si më poshtë:

Gjendja dhe ndryshimi i AAM-ve me kosto historike

Pasqyra Nr.4

| Gjendja më 31/12/2023 | Shtesat Blerë dhe Krijuar | Pakësime nga shitja | Pakësime të tjera nga çrregjistrimi | Pakësime të tjera (riciklim) | Riklasifikime | Gjendja më 31/12/2024 | Totali sipas zërave paraqitu në PPF |
|-----------------------|---------------------------|---------------------|-------------------------------------|------------------------------|---------------|-----------------------|-------------------------------------|
| | | | | | | | |



| | | | | | |
|-----------------------|-------------------|-------------------|--|----------------------|------------------|
| Pershtatje ambjentesh | | | | | |
| Makineri pajisje | 13,224,717 | 31,853,542 | | 45,078,259 | 56,163,91 |
| Mjete Transporti | 10,544,029 | 541,667 | | 11,085,696 | |
| Mobilje e orendi | 1,039,093 | 157,708 | | 1,196,801 | |
| Pajisje Informatike | 465,397 | 176,543 | | 641,940 | 3,244,827 |
| Te tjera AAM | 557,386 | 848,700 | | 1,406,086 | |
| TOTALI | 25,830,622 | 33,578,160 | | 59,408,782.00 | 59,408,78 |

Gjendja dhe ndryshimi i Amortizimit te AAM-ve

| | Gjendja më 31/12/2023 | Shtesat Amortizimi Vjetor | Pakësime nga shitja | Pakësime të tjera nga çrregjistrimi | Pakësime të tjera (riciklim) | Riklasifikime | Gjendja më 31/12/2024 | Totali sipas zërave paraqitu në PPF |
|---------------------|-----------------------|---------------------------|---------------------|-------------------------------------|------------------------------|---------------|-----------------------|-------------------------------------|
| Ndertesa | | | | | | | | |
| Makineri pajisje | 4,463,055 | 4,349,581 | | | | | 8,812,636 | 15,339,2 |
| Mjete Transporti | 5,409,451 | 1,117,193 | | | | | 6,526,644 | |
| Mobilje e orendi | 475,460 | 121,855 | | | | | 597,315 | |
| Pajisje Informatike | 329,583 | 59,700 | | | | | 389,283 | 1,304,731 |
| Te tjera AAM | 190,145 | 127,988 | | | | | 318,133 | |
| TOTALI | 10,867,694 | 5,776,317 | | | | | 16,644,011 | 16,644,01 |

Vlera Neto e AAM-ve

| | Gjendja më 31/12/2023 | Gjendja më 31/12/2024 | Totali sipas zërave paraqitu në PPF |
|---------------------|-----------------------|-----------------------|-------------------------------------|
| Ndertesa | | | |
| Makineri pajisje | 8,761,662 | 36,265,623 | 40,824,6 |
| Mjete Transporti | 5,134,578 | 4,559,052 | |
| Mobilje e orendi | 563,633 | 599,486 | |
| Pajisje Informatike | 135,814 | 252,657 | 1,940,096 |
| Pajisje Informatike | 367,241 | 1,087,953 | |
| TOTALI | 14,962,928 | 42,764,771 | 42,764,77 |



Për amortizimin e AAM-ve dhe AAJM-ve janë përdorur metodat dhe normat si më poshtë:

| | Metoda e vlerës së mbetur | Metoda Lineare mbi koston historike |
|---------------------------------|------------------------------|--|
| AAJM-të | | 15% |
| Makineri, pajisje, vegla pune | | 20% |
| Pajisje informatike | | 25% |
| Mobilje orendi dhe të tjera AAM | | 20% |

8. Hua e të ngjashme (TOTALI) **41,022,953**

Në PPF ky zë paraqitet analitikisht me numrin përkatës si më poshtë:

| | 31 Dhjetor-24 | 31 Dhjetor-23 | Ndryshimi +/- |
|--|-------------------|-------------------|-------------------|
| 8.1 Tituj të huamarrjes DASH | | | 0 |
| 8.2 Detyrime ndaj institucioneve të kredisë DASH | 28,359,653 | 25,139,071 | 3,220,582 |
| 8.3 Tituj të huamarrjes DAGJ | | | 0 |
| 8.4 Detyrime ndaj institucioneve të kredisë DAGJ | 12,663,300 | | 12,663,300 |
| Totali | 41,022,953 | 25,139,071 | 15,883,882 |

8.2 Detyrime ndaj institucioneve të kredisë (DASH) **28,359,653**

Vlera prej 28,359,653 lekë përbëhet nga vlera e Overdraftit prej 24,045,165 lekë, sipas situatës në datën 31 Dhjetor 2024 dhe 4,314,489 lekë përfaqëson këstin afatshkurtër të instrumentave financiare (kontratë Leasing) ku njësia ekonomike është e angazhuar. Këto vlera pritet të shlyhen brenda 12 muajve nga data e mbylljes së pasqyrave financiare.

9. Arkëtime në avancë për porosi **2,594,632**

| | 31 Dhjetor-24 | 31 Dhjetor-23 | Ndryshimi +/- |
|-------------------------------|------------------|------------------|-----------------|
| Aktëtime në avancë për porosi | 2,594,632 | 3,058,776 | -464,144 |
| Totali | 2,594,632 | 3,058,776 | -464,144 |

Vlera prej 2,594,632 lekë përfaqëson paradhëniet e marra nga klientët të cilat amortizohen (zbriten) me realizimin e shërbimeve sipas marrëveshjes mes palëve.

10. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit **30,407,753**

| | 31 Dhjetor-24 | 31 Dhjetor-23 | Ndryshimi +/- |
|---|---------------|---------------|---------------|
| Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit | 30,407,753 | 9,811,269 | 20,596,484 |

| | | | |
|---------------|-------------------|------------------|-------------------|
| Totali | <u>30,407,753</u> | <u>9,811,269</u> | <u>20,596,484</u> |
|---------------|-------------------|------------------|-------------------|

Vlera prej 30,407,753 lekë përfaqëson vlerën e furnitorëve gjendje më 31/12/2024 ende të palikujduar, për blerje të ndryshme në funksion të aktivitetit operacional.

11. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoq. & shënd. 4,528,540

| | <u>31 Dhjetor-24</u> | <u>31 Dhjetor-23</u> | <u>Ndryshimi +/-</u> |
|--|-------------------------|-------------------------|--------------------------|
| Te pagueshme ndaj punonjesve | <u>3,262,555</u> | <u>5,413,680</u> | <u>-2,151,125</u> |
| Të pagueshme për sigurime shoqërore & Shëndetësore | <u>1,265,985</u> | <u>1,139,928</u> | <u>126,057</u> |
| Totali | <u>4,528,540</u> | <u>6,553,608</u> | <u>-2,025,068</u> |

Vlera prej 4,528,540 lekë paraqet detyrimin e shoqërisë ndaj punonjësve për paga në masën 3,262,555 lekë si dhe 1,265,985 lekë për sigurime shoqërore & shëndetësore, detyrime të cilat i përkasin muajit Dhjetor 2024 të shlyera brenda muajit Janar 2025.

12. Të pagueshme për detyrime tatimore 25,442,466

Vlera prej 25,442,466 paraqet detyrimet ndaj shtetit për tatime e taksa. Përbërja e tyre paraqitet si më poshtë:

| | <u>31 Dhjetor-24</u> | <u>31 Dhjetor-23</u> | <u>Ndryshimi +/-</u> |
|------------------------------------|--------------------------|--------------------------|-------------------------|
| TVSH | <u>4,271,983</u> | <u>5,967,055</u> | <u>-1,695,072</u> |
| Detyrime nga akt kontrolli | <u>5,548,079</u> | <u>5,548,079</u> | <u>0</u> |
| Tatim mbi të ardhurat nga punësimi | <u>129,109</u> | <u>31,768</u> | <u>97,341</u> |
| Tatimi mbi Fitimin | <u>15,487,295</u> | <u>6,328,724</u> | <u>9,158,571</u> |
| Detyrime per taksa doganore | | | <u>0</u> |
| Tatimi në burim | <u>6,000</u> | <u>3,600</u> | <u>2,400</u> |
| Totali | <u>25,442,466</u> | <u>17,879,226</u> | <u>7,563,240</u> |

- **TVSH** – Vlera prej 4,271,983 lekë përfaqëson tepricën e Tvsh –së kreditore në dt 31 dhjetor 2024 e cila është një detyrim i pagueshëm dhe përputhet me gjendjen sipas deklaratave tatimore, detyrim i cili pritet të shlyhet në periudhën raportuese pasardhëse.
- **Tatim mbi të ardhurat nga punësimi** 129,109 lekë përfaqëson detyrimin e muajit dhjetor 2024, të cilat janë shlyer në janar 2025.
- **Detyrimi për tatimin mbi fitimin** - Vlera prej 15,487,295 lekë përfaqëson tepricën kreditore të llogarisë së tatim fitimit, çka tregon se vlera e parapaguar është më e vogël se tatimi i llogaritur bazuar në rezultatin faktik, detyrim i cili pritet të shlyhet brenda datës 31 Mars 2025.
- **Tatim në burim** në vlerën 6,000 lekë përfaqëson kryesisht vlerën e tatimit të mbajtur në burim për qeratë. Ky detyrim i përket muajit dhjetor 2024 dhe pritet të shlyhet në janar 2025.

13. Të tjera të pagueshme

Në këtë zë të pasqyrës paraqiten detyrime të tjera të krijuara gjatë marrëdhënieve tregtare me palët e treta.

| | 31 Dhjetor-24 | 31 Dhjetor-23 | Ndryshimi +/- |
|-----------------------|------------------|------------------|------------------|
| Të tjera të pagueshme | 7,852,000 | 6,822,838 | 1,029,162 |
| Totali | 7,852,000 | 6,822,838 | 1,029,162 |

PËR PASQYRËN E PERFORMANCËS

Shoqëria i ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet duke ndërtuar Pasqyrën e Performancës sipas natyrës.

14. Të Ardhurat Totale nga Aktiviteti i Shfrytëzimit 224,587,180

| Të ardhurat sipas grupeve në PP | Viti 2024 | Viti 2023 | Ndryshimi +/- |
|--|--------------------|--------------------|-------------------|
| 14.1 Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (Shitjet Neto) | 224,587,180 | 173,953,706 | 50,633,474 |
| 14.2 Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar | | | 0 |
| 14.3 Të ardhura të tjera të shfrytëzimit | 0 | 0 | 0 |
| Totali | 224,587,180 | 173,953,706 | 50,633,474 |

14.1 Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit 224,587,180 (Shitjet Neto të të mirave materiale, shërbimeve)

Të ardhurat e njësisë ekonomike sigurohen nga shitja e punimeve në fushën e ndërtimeve çka përbën dhe aktivitetin e saj kryesor, si dhe të ardhura të tjera dytësore sipas objektit të veprimtarisë:

Në pasqyrën e performancës ky zë është paraqitur i detajuar si më poshtë:

| | Viti 2024 | Viti 2023 | Ndryshimi +/- |
|--|--------------------|--------------------|-------------------|
| 14.1 Te ardhurat nga aktiviteti kryesor | 219,245,760 | 169,893,835 | 49,351,925 |
| 14.1 Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 1 | 5,341,420 | | 5,341,420 |
| 14.1 Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 2 | | | 0 |
| 14.1 Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 3 | | | 0 |
| 14.1 Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit | | 4,059,871 | -4,059,871 |
| Totali | 224,587,180 | 173,953,706 | 50,633,474 |

Një paraqitje e tillë është bërë jo vetëm referuar rëndësisë së tyre (primare dhe sekondare), por edhe natyrës së tyre duke bërë detajimet e nevojshme brenda grupeve të të ardhurave nga aktiviteti dytësor. Ndarja brenda këtij grupimi bazohet gjithashtu nga qëllimi që ka në vetvete kompania për të ofruar shërbime të tjera pavarësisht vlerës së tyre pra, pavarësisht arritjes apo jo të qëllimit apo objektivit të saj.

14.2 Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar

14.3 Të ardhura të tjera të shfrytëzimit



15. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme (50,633,943)
Në pasqyrën e performancës ky zë paraqitet si më poshtë :

| | Viti 2024 | Viti 2023 | Ndryshimi +/- |
|---|--------------------|--------------------|--------------------|
| 15.1 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | -32,802,328 | -63,849,397 | -31,047,069 |
| 15.2 Të tjera shpenzime | -17,831,615 | -12,946,920 | 4,884,695 |
| Totali | -50,633,943 | -76,796,317 | -26,162,374 |

Në nënzërin “**Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**” paraqiten kostot e materialeve të përdorura në punimet e kryera si dhe shërbime të tjera të drejtpërdrejta të lidhura me këto punime.

Në nënzërin “**Të tjera shpenzime**” paraqiten shpenzime për furnitura të tjera ndihmëse me natyrë të pastokueshme që bëhen në procesin e kryerjes së punimeve apo të tjera ndihmëse në funksion të aktiviteteve të shitjes dhe administrimit të shoqërisë si psh naftë për mjetet e punes, mjete të tjera pune, qiramarrje e mjeteve të punës etj.

16. Shpenzime personeli (36,071,035)

Në shpenzimet për personelin janë përfshirë shpenzimet për paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore e shëndetësore të llogaritura si dhe të tjera shpenzime për personelin.

Në pasqyrën e performancës ato paraqiten si më poshtë:

| | Viti 2024 | Viti 2023 | Ndryshimi +/- |
|---|--------------------|--------------------|------------------|
| 16.1 Paga dhe shpërblime | -30,925,488 | -23,950,035 | 6,975,453 |
| 16.2 Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore | -5,145,547 | -3,996,885 | 1,148,662 |
| Totali | -36,071,035 | -27,946,920 | 8,124,115 |

16.1 Paga dhe shpërblime (30,925,488)

Përfaqëson shpenzimet e llogaritura për paga dhe shpërblime të tjera që lidhen me marrëdhëniet e punësimit.

16.2 Shpenzime të sigurimeve shoqërore / shëndetësore (5,145,547)

Gjatë vitit shoqëria ka llogaritur dhe deklaruar në përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi të ardhurat nga punësimi, kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore për punonjësit. Në këtë zë të shpenzimeve paraqitet ajo pjesë e kontributeve që shoqëria llogarit dhe paguan efektivisht mbi fondin e pagave për punonjësit e saj, pra ajo pjesë e kontributeve që përballohet nga kompania.

17. Shpenzime konsumi dhe amortizimi (5,776,317)

Përfaqëson amortizimin e aktiveve aftagjata materiale dhe jo materiale si më poshtë:

| | Viti 2024 | Viti 2023 | Ndryshimi +/- |
|----------------|------------|------------|---------------|
| Amortizim AAM | -5,776,317 | -2,948,956 | 2,827,361 |
| Amortizim AAJM | | | 0 |



| | | | |
|---------------|-------------------|-------------------|------------------|
| Totali | -5,776,317 | -2,948,956 | 2,827,361 |
|---------------|-------------------|-------------------|------------------|

Për më tepër shiko shënimet nr. 7 (7.1 : 7.4)

18. Shpenzime të tjera shfrytëzimi (30,049,812)

Për vitin 2024 ky zë paraqitet në masën 30,049,812 lekë. Në këtë zë të pasqyrës së performancës janë paraqitur shpenzime operacionale (kryesisht shërbime) të cilat lidhen me shitjen si dhe shpenzime të tjera të përgjithshme dhe administrative të tilla si:

- Shpenzime qeraje të ambjenteve ku ndodhet njësia administrative e shoqëris
- Shërbime riparimi & mirëmbajtje automjetet
- Prime sigurimi për mjetet e punës
- Shërbime kontabël & të tjera ligjore
- Shpenzime të tjera lidhur me fiskalizimin
- Komisione bankare
- Shpenzime për udhëtime e dieta
- Taksa dhe tarifa vendore
- Penalitete

19. Të ardhura / Shpenzime interesi (2,871,397)

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi paraqiten në pasqyrë me vlerën neto të tyre. Ato njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe paraqiten si më poshtë:

| | Viti 2024 | Viti 2023 | Ndryshimi +/- |
|---------------------|-------------------|-------------------|------------------|
| Të ardhura interesi | 93 | 12,366 | 12,273 |
| Shpenzime interesi | -2,871,490 | -1,229,201 | 1,642,289 |
| Totali | -2,871,397 | -1,216,835 | 1,654,562 |

20. Të ardhura/ Shpenzime të tjera financiare (Kurset e këmbimit) 55,556

Ky zë përbëhet nga fitim – humbjet nga kursi i këmbimit. Ato janë paraqitur në pasqyrën e performancës me vlerën neto dhe rezultojnë një fitim prej 55,556 lekë, rezultat i cili përbëhet si më poshtë:

| | Viti 2024 | Viti 2023 |
|-----------------------------|---------------|----------------|
| Fitim nga kursi i këmbimit | 2,135,457 | 1,753,860 |
| Humbje nga kursi i këmbimit | -2,079,901 | -1,106,683 |
| Totali | 55,556 | 647,177 |

21. Shpenzime tatim fitimi (15,181,654)

| | Viti 204 | Viti 2023 |
|---------------------------|--------------------|-------------------|
| Tatim fitimi i llogaritur | -15,181,654 | -6,708,469 |
| Totali | -15,181,654 | -6,708,469 |



Shpenzimet e tatimit mbi fitimin përbëhen vetëm nga tatim fitimi aktual i cili është përlogaritur mbi bazën e rezultatit faktik pavarësisht parapagimeve të kryera për këtë qëllim gjatë vitit, pra përfaqëson “Shpenzimet e tatimit mbi fitimin e periudhës” dhe përfshihet drejtpërdrejt në pasqyrën e performancës.

Llogaritja e tij është si më poshtë:

| | Viti 2024 | Viti 2023 |
|--|-------------------|------------------|
| Fitimi Kontabël (Ekonomik) | 99,240,232 | 36,168,466 |
| Shpenzime të panjohura | 1,970,793 | 8,554,658 |
| Fitimi i tatueshëm (Fiskal) | 101,211,025 | 44,723,124 |
| Tatim Fitimi i llogaritur (15%) | 15,181,654 | 6,708,469 |

PËR PASQYRËN E MJETEVE MONETARE

Pasqyra e mjeteve monetare është ndërtuar sipas metodës indirekte.

Ajo paraqet flukset monetare të gjeneruara sipas tre aktiviteteve: shfrytëzim, investim & financim

Në pjesën e parë të shënimeve janë paraqitur rregullimet në lidhje me elementët jomonetar të të ardhurave & shpenzimeve , më pas janë paraqitur rregullimet e rezultatit duke përfshirë të ardhura & shpenzime që i takojnë aktivitetit të investimit e aktivitetit të financimit në mënyrë që të sigurohet informacion i saktë dhe i qartë në lidhje me fluksin e mjeteve monetare gjeneruar nga secili aktivitet.

4. INFORMACION TJETËR I NEVOJSHËM

1- Angazhime dhe pasiguri

i. Çështje gjyqësore

Nuk ka ndonjë proces gjyqësor të filluar gjatë vitit 2024.

2- Ngjarje pas mbylljes së vitit financiar

Drejtimi i shoqërisë nuk është në dijeni për ndonjë ngjarje të rëndësishme që do të kërkonte rregullime ose shënime shtesë në pasqyrat financiare.

Pasqyrat Financiare të shoqërisë për ushtrimin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 janë miratuar nga administratori i shoqërisë më dt. 20/03/2025

HARTUES
R&M Consulting Shpk
ELTON GAZIDENI



ADMINISTRATORI
HENDI SHEHAJ

